Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Departamenti juridik dhe policorë i konfederates EJPD
Enti Federativ i Migracionit

Publikim medial

Data: 21. Gusht 2012

Masa të veçanta pranë kërkesave për azil nga shtetet evropiane të sigurta ndajë përndjekjeve

Enti Federativ për Migracion (BFM) kërkesat për azil nga shtetet evropiane të sigurta ndaj përndjekjeve i trajton me prioritet të lartë: Në qendrën për pranim dhe procedura në Basel vendoset brenda 48 orëve mbi të gjitha rastet me instancën më të lartë, në të cilat pas intervistës nuk ka më nevojë për sqarime të mëtutjeshme. Me këtë BFM-ja i vihet përballë eskalacionit të situatës dhe siguron, që të përndjekurit e vërtet edhe gjatë muajve të ardhshëm të kenë mundësi qëndrimi në institucionet tona. Në muajt e verës numri i kërkesave për azil nga shtetet evropiane të liruara nga obligimi i vizave ka shënuar rritje të dukshme. Praktikisht të gjitha këto kërkesa janë të pa arsyetueshme dhe sjellin deri te tej ngarkimi i kapaciteteve në qendrat për azil.

Rritje e dukshme e kërkesave nga shtetet e liruara nga obligimi i vizave

Enti Federativ për Migracion në muajt e fundit shënoi një rritje të kërkesave për azil të personave, të cilët vijnë nga vendet e tyre të origjinës dhe mund të hynë në Zvicër pa vizë. Në këtë rast bëhet fjalë për, me emërim të shteteve, për shtetas të Maqedonisë, Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës. Obligimi i vizave u hoq me kërkesën e EU-së me 2009 respektivisht 2010 për tërë hapësirën e Schengen-it. Vetëm Korrik të vitit 2012 numri i kërkesave për azil nga Maqedonia përkundrejt muajit të mëparshëm u rrit për 83%, e ato nga Serbia për 68%.

Kërkesat e pa arsyeshme për azil e dëmtojnë sistemin zviceran të azilit

Në periudhën kohore prej 1.Janarit 2011 deri 31. Korrik 2012 gjithësej 4‘593 persona nga Bosnja e Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia paraqitën kërkesa për azil në Zvicër. Në periudhën e njëjtë kohore azili ju garantua 20 personave nga këto shtete. Kjo i përgjigjet kuotës së pranimit prej 0,5%. Këta persona kanë gjasë të vogël për marrjen e plotë të azilit në Zvicër. Sidomos pasi që Këshilli Federativ këto shtete i konsideron si shtete të sigurta (Save Countries), që do të thotë se mbrojtja adekuate nga ana e shtetit, edhe për pakica, në princip është e garantuar. Për këtë arsye mund të thuhet, që kërkuesit përkatës të azilit sipas të gjitha rregullave nuk

kanë nevojë për mbrojtje nga përndjekjet në kuptim të ligjit për azil. Njëkohësisht këta azilkërkues i zënë vendet në strukturat e azilit zviceran, gjë që dërgon deri te ngushtimi i kapaciteteve. Njerëzit, të cilët me të vërtet kanë nevojë për mbrojtje në Zvicër, ndeshen me qendra të tej ngarkuara azili. Kjo gjendje e dëmton reputacionin e sistemit të azilit në Zvicër i cili bazohet në Kushtetutshmëri, që personat vërtet të përndjekur të gjejnë strehim këtu dhe të pranohen me nderë.

Ndihma në shtetin amë
Në anën tjetër kërkuesve të azilit, të cilët dukshëm paraqesin kërkesa të pa arsyetuara, këtu nuk mund të ju ndihmohet. Ata do duheshin të e lëshojnë sa më shpejt vendin. Por sido qoftë, Zvicra mundohet qe disa vite të ju përmirëson situatën në shtetet amë. Në këtë mënyrë Federata ka lidhur partneritet migracioni me Serbinë dhe Bosnjën e Hercegovinën, i cili e intensifikon bashkëpunimin me këto shtete dhe mundëson arritjen e ndihmave të synuara. Një shembull ndër shumë tjerët është projekti i ndërtimit të banesave për familjet e romëve në Bosnje e Hercegovinë, të cilin e bartë Federata.

Procedura 48-orëshe
Enti federative i migracionit tani zgjedhë masa specifike, për përpunimin eficient të kërkesave për azil nga shtetet e sigurta evropiane (Save Countries)dhe arritjen e shpejtë të vendimeve mbi ato. Për këtë ekipe të ndryshme janë të stacionuara në qendrën e pranimit dhe procedurave në Bazel (EVZ), të përbërë nga profesionist federativ për azil, përfaqësues të organizatave ndihmëse dhe përkthyes. Ata realizojnë aty procedurat me shtetas të shteteve të përmendura dhe vendosin brenda 48 orëve prej momentit të intervistës së parë mbi personin. Kjo bëhet në të gjitha ato raste kur pas intervistës mbi arsyet e kërkesës për azil janë definuar në mënyrë të duhur ligjore dhe nuk ka nevojë për sqarime të mëtutjeshme. Të gjitha garancitë e procesit – posaçërisht ato të mundësive të ankesave pranë Gjyqit Administrativ Federativ – mbesin në fuqi edhe përkundër përshpejtimit të procesit. Këtu zbatohen kriteret e zakonshme kualitative. Zvicra do të ju garanton kërkuesve të azilit edhe më tutje procedura të drejta.

Bashkëpunimi me shtetet amë: Në një anë Federata shfrytëzon hapësirat e mundshme ligjore në fushën e azilit. Në anën tjetër ajo gjatë përfundimit të procedurës bashkëpunon ngushtë me shtetet amë, në mënyrë që dokumentacioni për udhëtim të përgatitet shpejtë. Për këtë qëllim këtu intensifikohet ndërrimi i informatave me shtetet e prekura. Bisedimet me përfaqësues të autoriteteve tani më janë bërë.

Janë paraparë masat vijuese:

Bisedë paraprake: Për t’u njoftuar azilkërkuesit e këtyre shteteve se me çfarë masa të pafavorëshme për ta do të ndeshen pranë parashtrimit të kërkesës për azil, bashkëpunëtorët e EVZ Bazel bisedojnë me ata pranë arritjes së tyre aty dhe ju dorëzojnë atyre një fletushkë me informata kryesore mbi masat e marrura.

Heqja e ndihmave për kthim: Që nga heqja e obligimit të vizave për shtetet

ballkanike, personave të këtyre shteteve janë fshirë nga lista e ndihmave për kthim. Kjo masë zbatohet që nga Prilli i vitit 2012. Risi është edhe fakti që BFM kërkuesëve të azilit nga këto shtete nuk ju paguan më shpenzimet e udhëtimit – përjashtim bëjnë personat e lënduara dhe rastet speciale.

Ndalesa e hyrjes në shtet: Me rastin e refuzimit të kërkesës për azil të parashtruar nga personat e shteteve evropiane të liruara nga obligimi i vizave të cilët edhe nuk kanë raspektuar afatin e skadimit të vizës dhe nuk kanë lëshuar vendin, zakonisht për këtë lëshohet ndalesa e hyrjes në vend. E njëjta vlen edhe për persona të cilët kanë prishur rendin publik, disa herë në mënyrë të pa arsyeshme kanë paraqitur kërkesë për azil apo për raste drastike të keqëpërdorimit Kjo ndalesë e hyrjes vlen për të gjitha shtetet e Schengen-it, porse plotëfuqizohet me ngadalësi, kështu që personi i prekur mund të kthehet vullnetarisht në shtetin amë.

Informata tjera mund të i gjeni në internet nën www.bfm.admin.ch.
Kontakti/Pyetje shtesë: Gaby Szöllösy, Enti Federativ i Migracionit, Tel. 031 325 98 80 / 076 336 47 98